



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.1026/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “LENI-ING” Sh.P.K., seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, rr. “Don Bosko” pallatet e Arbërit Kati I, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit N.M. , avokate me seli në Prizren, kundër debitorëve; “Grand-DCP” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811494947, “Grand Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811494947, dhe “Grand International Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811494947, me seli në Prishtinë, rr. “Muharrem fejza” , të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B.D.H. avokat me seli në Prishtinë , lidhur me çështjen përmbarimore në bazë të faturave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1001/22 të datës 29.05.2023, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “LENI-ING” Sh.P.K., seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, rr. “Don Bosko” pallatet e Arbërit Kati I, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1001/22 të datës 29.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës - Departamenti Për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1001/22 të datës 29.05.2023 e ka aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorëve “Grand-DCP” Sh.P.K., “Grand Group” Sh.P.K., dhe “Grand International Group” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 492/21, i lejuar me datë 05.08.2021, nga Përmbaruesi Privat Mehdi S. Reshani e ka anuluar. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar kreditori që debitorëve t’ia paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimi në vlerë prej 487.50 Euro (katërqind e tetëdhjetë e shtatë Euro e pesëdhjetë Cent), në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori “LENI-ING” Sh.P.K., seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, rr. “Don Bosko” pallatet e Arbërit Kati I, për shkak të shkeljeve

esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e kreditorit të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i atakuar KPPP.nr.1001/22 i datës 29.05.2023 të ndryshohet duke e refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorës dhe të lihet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.492/21 i datës 05.08.2021 i përmbartuesit privat apo aktvendimi të prishet dhe lënda të kthehet në dhomat e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori, me propozimin që të refuzohet si e pabazuar ankesa e kreditorit, ndërsa aktvendimi KPPP.nr.1001/22 i datës 29.05.2023 vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, faturës nr. 25, e datës 01.07.2021, faturës nr. 26, e datës 01.07.2021, si dhe faturës nr. 27, e datës 01.07.2021, ka lejuar urdhrin për përmbartim P.nr. 492/21, të datës 05.08.2021, me të cilin janë urdhëruar debitorët “Grand-DCP Sh.P.K., “Grand Group” Sh.P.K., dhe “Grand International Group” Sh.P.K., që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimin të urdhrin, të përmbushin detyrimin në shumë prej 410,919.00 Euro ndaj kreditorit, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në lartësi prej EUR 487.50, sipas rregullores mbi tarifat e avokatëve.

Debitorët, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbartim, me arsyetim se dokumentet mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë dhe se propozimi për përmbartim nuk ka bazë juridik. Tutje, përfaqësuesi i autorizuar i debitorëve ka theksuar se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri nuk janë nënshkruar apo vulosur nga debitorët, e për më tepër të njëjtat janë refuzuar, ngase debitorët nuk kanë porositur asnjë punë nga kreditori. Sa i përket vërejtjes paraprakë për pagesën e borxhit të pranuar nga kreditori, debitorët kanë theksuar se të njëjtën e kanë kundërshtuar për shkak se nuk kanë porositur ndonjë punë nga kreditori dhe se nuk kanë asnjë detyrim, qoftë kontraktual apo financiar, ndaj kreditorit. Ndërsa, kanë shtuar se së bashku me kundërshtim e paraqitur ndaj vërejtjes për pagesën e borxhit, kreditorit ia kanë kthyer faturat origjinale. Për këto arsye, gjykatës i kanë propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorëve, urdhri përmbartimor të anulohet si dhe të obligohet kreditori që debitorëve t’ia paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimin në vlerë prej 487.50Euro, konform rregullores për tarifat e avokatëve.

Kreditori, përmes përfaqësueses së autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim duke theksuar se propozimi për përmbartim është paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore dhe i njëjti është i bazuar në dokumente të besueshme. Tutje, ka kundërshtuar pretendimet e debitorëve të paraqitura

në prapësim lidhur me marrëdhënien mes palëve për ofrimin e shërbimeve konsulentë, përkatësisht projektimin e projekteve, me arsyetim se porosia e debitorëve për kryerjen e punëve-projekteve, vërtetohet përmes emali të shkëmbyera gjatë punimeve. Ka shtuar se debitorëve i është dërguar paraprakisht vërtetja me shkrim para inicimit të procedurës përmbartimore përmes së cilës i është dhënë afat për përmbushje të detyrimit prej 7 ditësh, mirëpo që debitorët nuk kanë ndërmarr veprime për shlyerjen e detyrimit, ndërsa gjykatës i ka propozuar që të mbahet seancë dëgjimore dhe të dëgjohen dëshmitarët për vërtetimin e faktit se debitorët sipas dokumentit të besueshëm nuk kanë përmbushur detyrimin ndaj kreditorit. Në fund, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorëve, urdhrin përmbartimor ta lej në fuqi si dhe ti detyroj debitorët që Faqe 3 nga 4 në emër të përgjigjes në prapësim, kreditorit t’ia paguajnë shumën prej 487.50 Euro, sipas rregullores mbi tarifat e avokatëve.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1001/22 të datës 29.05.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimi i debitorëve “Grand-DCP” Sh.P.K., “Grand Group” Sh.P.K., dhe “Grand International Group” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 492/21, i lejuar me datë 05.08.2021, nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani e ka anuluar. Duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se nr. 25, e datës 01.07.2021, fatura nr. 26, e datës 01.07.2021, si dhe fatura nr. 27, e datës 01.07.2021 mbi bazën e të cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se, nga shkresat e lëndës, nuk rezulton se këto fatura i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit dhe se të njëjtat debitori i ka pranuar si të rregullta.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit, për arsye se më dispozitën e Nenit 29, paragrafi 1 të LPP-së, përcakton se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në pikën 1.3 të të njëjtit nen, përcaktohet se *“fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla”*. Ndërsa në nenit 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Po ashtu me nenin 37 i LPP-së, përcakton se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo*

kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit". Në rastin konkret rezulton se fatura nr. 25, e datës 01.07.2021, fatura nr. 26, e datës 01.07.2021, si dhe fatura nr. 27, e datës 01.07.2021, mbi bazën e të cilave është lejuar propozimi për përmbaerim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se, nga shkresat e lëndës, nuk rezulton se këto fatura i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit dhe se të njëjtat debitorit i ka pranuar si të rregullta.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbaerimore, respektivisht është lejuar përmbaerimi nuk i plotëson kushtet bë mënyrë kumulative qe duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitorit, përkatësisht faturat nuk e përmbajnë nënshkrimin e debitorit si element esencial për të qenë dokument i përmbaerueshëm.

Po ashtu , Kjo Gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejta ka vlerësuar edhe kur ka konstatuar se dorëzimi i faturave përmes postës në adresë të debitorëve nuk mund ta konsiderohet si dorëzim dhe pranim i rregullt nga ana e debitorëve, ngase nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga dëftesa e postës nr., e datës 20.08.2021, rezulton se debitorët pas pranimit të dërgesës postare me përmbajtje të faturave kanë paraqitur përgjigje në vërejtje për shlyerjen e borxhit, duke i refuzuar edhe faturat si të papranueshme. Prandaj, meqenëse faturat janë kundërshtuar pas pranimit të tyre, nënkupton se debitorët të njëjtat nuk i kanë pranuar dhe se nuk janë pajtuar me përmbajtjen e tyre. Për këto arsye, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se faturat e panënskruara dhe të kundërshtuara nga ana e debitorit, paraqesin dokumentet të njëanshme, dhe si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përmbaerim. Mbi këtë bazë, Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbaerim, e mbi bazën e të cilit Përmbaeruesi privat ka lejuar përmbaerimin, nuk ka tipare të përmbaerueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaeruesit duhet të anulohet.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, të njëjtat i vlerëson si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se prapësimi nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, ngase fatura në bazë të së cilës është lëshuar Urdhri Përmbaerimor, nuk mund të trajtohet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, si dhe përmban të gjitha të gjitha elementet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaerimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1026/23 dt. 21.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova